




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në pajtim me nenin 52.2 shkronja a), nenin 112.5 Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 12479 të dt. 21.11.2008, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 13.04.2011, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me datën 27.04.2011, miratoi këtë:

V E N D I M **PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT PËR AKTE NORMATIVE**

I. Emërohet Komisioni për akte normative.

Anëtarët e emëruar të komisionit janë:

- | | |
|-----------------------------|------------------------------|
| 1. Hevzi Matoshi, kryesues, | 7. Bardhyl Sylja, anëtar, |
| 2. Blerim Beshtica, anëtar, | 8. Gëzim Kllokoqi, anëtar, |
| 3. Besnik Surdulli, anëtar, | 9. Zhivojin Xhakliq, anëtar, |
| 4. Arben Mehmeti, anëtar, | 10. Renan Imami, anëtar, |
| 5. Sadudin Berisha, anëtar, | 11. Ibrahim Neziri, anëtar, |
| 6. Sokol Haziri, anëtar, | |

II. Komisioni do të hartojë akte të ndryshme normative që janë në kompetencë të Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe sipas nevojës dhe të institucioneve tjera në varësi të komunës, dhe pas hartimit të çdo akti, të njëjtin do ta paraqes për miratim në Kuvendin Komunal.

III. Përfaqësuesit e grupimeve politike gjatë caktimit të përbërjes së numrit të anëtarëve të këtij komisioni me marrëveshje mund të bëjnë dizajnimit e përbërjes së tyre, përderisa lëvizjet përbrenda komisionit mund të bëhen në secilën kohë.

IV. Komisionin, në cilësinë e zyrtarit do ta ndihmoj z.Sali Hasani, i cili do të mbaj procesverbalin, do të bëjë lektorimin dhe punët tjera teknike për mbarëvajtjen e punës së komisionit.

V. Komisioni emërohet me mandat të njëjtë si të anëtarëve të kuvendit.

VI. Komisioni për punën e kryer do të kompensohet me vendim të veçantë.

VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset kryesuesi i KK-Gjilani.

VIII. Vendimi është i plotfuqishëm me aktin e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

01. Nr. 16/5663
Gjilan, 27.04.2011

Kuvendi i Komunës.

Izmi Zeka, Kryesues